



## VENDIMI I PAPRANUESHMËRISË

**Data e miratimit:** 08.06.2011

**Nr. i rastit:** 2011-09

**Z. Bojan Mirkovic**

kundër

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 08 qershor 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, Kryesues  
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare  
Znj. Esma ERTERZI, anëtare

Asistuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore  
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PARA PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 12 prill 2011.

## **II. FAKTET**

### **Parathënie**

2. Parashtruesi i ankesës ishte pranuar në punë nga EULEX-i në Kosovë më 28 korrik 2008, si roje sigurimi në Zyrën e Shefit të Misionit (ShM), ku ai ka punuar sipas kontratës së tij të punës deri më 14 qershor 2010. Ai kishte të drejtë t'i gëzonte përfitimet nga sigurimi shëndetësor i Kompanisë Ndërkombëtare të Sigurimeve Vanbreda (më vonë "Vanbreda") që nga 1 gushti 2009.

### **Ngjarjet**

3. Sipas parashtruesit të ankesës, ai ishte mjekuar në një spital në Beograd (Serbi), me datat 27 qershor, 29 qershor, 13 korrik, 31 korrik, 27 gusht, 4 shtator dhe 24 tetor 2009. Ai ka deklaruar se kishte dërguar faturat e spitalit së bashku me vërtetimin e pagesave për procedurat mjekësore tek kompanitë e autorizuara të sigurimit: te Kompania e Sigurimit Dukagjini (më vonë përmendet si: "Dukagjini") dhe te Vanbreda.
4. Në një datë që nuk është saktësuar kah fundi i muajit tetor të vitit 2009, parashtruesi i ankesës kishte pranuar një letër përmes postës elektronike nga Vanbreda, ku thuhej se atij nuk do t'i kompensohej fatura e mjekimit e datës 27 gusht 2009, pasi që kishin lindur dyshime lidhur me vërtetësinë e saj. Vanbreda e kishte vë më dijeni atë se Administrata e EULEX-it në Kosovë ishte njoftuar rreth kësaj çështje.

### **Procedurat**

5. Një hetues nga Njësia e Hetimeve të Brendshme të EULEX-it kishte kërkuar nga parashtruesi i ankesës që të jep një deklaratë zyrtare lidhur me këtë çështje me datën 30 nëntor 2009. Kushëriri i tij gjithashtu ishte intervistuar përmes telefonit. Deklaratat janë marrë nga parashtruesi i ankesës më 2 dhjetor 2009 dhe më 7 dhjetor 2009. Parashtruesi i ankesës dyshohej se kishte ndryshuar datën në faturën e shumës prej 1,160 dollarë amerikan, në mënyrë që të përfitonte nga Vanbreda, edhe pse ai tashmë ishte kompensuar për këtë mjekim nga Dukagjini më 27 qershor.
6. Njësia e Hetimeve të Brendshme të EULEX-it kishte kryer raportin e saj të hetimit më 11 dhjetor 2009. Aty u arrit në përfundim se një Komisioni Disiplinor i Hetimeve (më vonë përmendet si "Komisioni") duhej të krijohej për të shqyrtuar çështjen. Aty rekomandohej se fakti që tashmë parashtruesit të ankesës i ishin shqiptuar masat disiplinore joformale nga menaxheri i tij duhej të merrej parasysh. Për shkak të natyrës së rëndë të kundërvajtjes, e cila u cilësua se ishte mashtrim, ishte rekomanduar që të ndërmerreshin masat më të ashpra disiplinore të mundshme.

7. Komisioni ka gjetur se prova e mbledhur nga Njësia e Hetimeve të Brendshme ishte e mjaftueshme për krijimin e fakteve të rastit, dhe se nuk e ka cilësuar të domosdoshme të dëgjohet personalisht parashtruesi i ankesës. Më 5 shkurt 2010, Komisioni arriti në përfundimin se përpjekja e qëllimshme e parashtruesit të ankesës që të kompensohej për mjekimin shëndetësor nga të dy kompanitë, përbënte shkelje të rëndë të Kodit të Mirësjelljes, për të cilën masa më e përshtatshme disiplinore ishte shkëputja e kontratës së tij të punës.
8. Më 9 shkurt 2010, kontrata e punës së parashtruesit të ankesës ishte pezulluar nga Zëvendësi i ShM. Pas një ankese të pasuksesshme tek ShM, kontrata e punës së parashtruesit të ankesës ishte shkëputur më 28 prill 2010.

### **III. RREGULLORET NË FUQI**

9. Sjelljet e anëtarëve të personelit janë të rregulluara përmes Kodit të Mirësjelljes dhe Kodit Disiplinor (më vonë përmendet si KM). Në rast të ndonjë shkelje të dyshuar të KM, ShM do të nis hetimet e brendshme lidhur me çështjen. Pastaj, hetimet do të kryhen nga Njësia e Brendshme e Hetimeve.
10. Nëse akuzat janë vërtetuar, ShM mundet, pas marrjes së Raportit Përfundimtar të Hetimit, që të caktoj një Komision Disiplinor kompetent për të vendosur që të rekomandoj masat e duhura disiplinore. Ky Komision Disiplinor mundet që të kërkoj nga anëtari i personelit apo personat e tjerë të dëshmojnë, mirëpo kjo nuk ishte e domosdoshme.. ShM do të merr vendim gjatë përfundimit të rastit dhe rreth masave të mundshme disiplinore që duhet të merren. Anëtari i stafit ka të drejtë të bëjë ankese kundër vendimit të marrë nga ShM. Vendimi i ShM i marrë në procedurën e ankesës është përfundimtar.

### **IV. ANKESAT**

11. Parashtruesi i ankesës pretendon se ai nuk është trajtuar në mënyrë të drejtë gjatë hetimeve, dhe se mbikëqyrësit e tij nuk janë pyetur dhe se nuk kishte asnjë provë të mjaftueshme kundër tij për shqiptimin e masës disiplinore. Ai ankohet se nuk është dëgjuar personalisht nga Komisioni, përderisa u mor vendimi rreth shkëputjes së kontratës së tij të punës.

### **V. LIGJI**

12. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos se a ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriterin e pranueshmërisë të përcaktuar në Rregulloren 29 të Rregulloreve të Punës.

13. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1 i Rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i të Kosovës, gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
14. Rasti i parashtruesit të ankesës ka të bëjë me një hetim të kryer nga Njësia e Hetimeve të Brendshme të EULEX-it dhe Komisionit Disiplinor të Hetimit të EULEX-it, rreth një shkelje të supozuar të Kodit të Mirësjelljes së EULEX-it në Kosovë. Vendimit përfundimtar për shkëputjen e kontratës së punës është marrë nga ShM i EULEX-it në Kosovë.
15. Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë, gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv. Çështjet që kanë të bëjnë me punësim dhe me masat e brendshme disiplinore janë përgjegjësi e EULEX-it. Prandaj, kjo ankesë nuk hyn në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë, mandat i cili kufizohet në çështjet që kanë të bëjnë me policisë, drejtësinë dhe doganat.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Paneli, njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, konstaton se sipas Nenit 29 (d) të Rregullores së Punës ankesa është e pabazuar, dhe

#### **SHPALL KËTË ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,



John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio BALSAMO  
Kryesues i Panelit